



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	4-18-15139
Nr. i faq.	25
Data	30/06/2021



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

DATË/A:	30.06.2021
PËR/ZA/ TO:	z. Hekuran Murati - Ministër i MFPT z. Remzi Sylejmani –zv. Drejtor i Buxhetit, MFPT znj. Adelina Zekaj - Analiste e Buxhetit komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për dorëzimin e KAB-it komunal 2023/2025


Të nderuar,

Kuvendi Komunal i Komunës së Junikut, në mbledhjen e mbajtur me 29.06.2021, aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023/2025. Pas aprovimit nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi Komunal, si dhe kompletimit të dokumentacionit, kërkojmë nga Institucioni i lartpërmendur që të bëjë të mundshëm pranimin e dokumentacionit nga Komuna e Junikut.

Dokumentet që i bashkangjiten kërkesës janë:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023/2025
2. Vendimi mbi aprovimin e KAB-it, nga Kuvendi Komunal Junik

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

2023- 2025

JUNIK, 2022

I. KORNIZA AFATMESME BUXHETORE PËR K.K – JUNIK

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) që po e paraqesim këtu është një dokument i cili miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës. Grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake. Shpenzimet janë planifikuar ashtu që të pasqyrojnë prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuara në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.

Hartimi i KAB-it 2023-2025 është një kërkesë obligative dhe kërkohet përmes Qarkores Buxhetore 2023/01 për Komunat, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ne kemi shqyrtuar KAB-in në kuptim të planifikimit afatmesëm. Karakteristikat më kryesore të tij janë si në vijim:

- Parashikimet ekonomike dhe buxhetore;
- Strategjinë zhvillimore komunale;
- Totalët e vlerësuar të të hyrave nga të gjitha burimet e financim;
- Caqet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe ;
- Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve

Prandaj procesin që kemi ndjekur ne është si në vijim:

- Rishikimi i politikave të të hyrave dhe identifikimi i të hyrave
- Paraqitja e prioritetëve strategjike dhe rezultateve të pritura
- Rishikimi i ndërlidhjes së buxhetit të kaluar me prioritetet dhe rezultatet e arritura.
- Planifikimi i buxhetit për periudhë afatmesme për të punuar drejt arritjes së prioritetëve strategjike
- Zhvillimi i indikatorëve dhe caqeve për të matur progresin drejt prioritetëve strategjike dhe rezultateve

KAB paraqet prioritetet komunale të shpërndarjes së mjeteve për periudhën 2023-2025.

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës së Junikut është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e cila është ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2023/2025 të dhëna nga MFPT përmes qarkores buxhetore 2023/01 .

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB – Komunal do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Junikut si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2023 – 2025, gjithnjë duke u bazuar në :

1. Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
2. Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
3. Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
4. Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

II. OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Me kornizën afatmesme buxhetore 2023–2025 të Komunës së Junikut synohen të arrihen këto objektiva:

- ❖ Zhvilloj, promovoj dhe rigjeneroj infrastrukturën lokale;
- ❖ Përmirësoj ambientin për të jetuar;
- ❖ Përmirësoj sigurinë dhe shëndetin e komunitetit;
- ❖ Zhvilloj sferën e shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit;
- ❖ Ofroj mjete për nevojtarët dhe të dëmtuarit;
- ❖ Përkrah dhe zhvilloj biznesin dhe aftësitë individuale të talenteve etj.

III. Perspektiva e politikave fiskale

Korniza makroekonomike

Komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), prandaj Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2023-2025 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Parashikimi i të hyrave komunale

Të hyrat komunale të Komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores mbi Taksat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj të hyra, siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Tabela 1. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

	Burimet e te hyrave	2022 Buxheti	2023	2024	2025
			Projeksioni		
1	Gjithsej grantet ndërqeveritare	1,499,553	1,718,016	1,824,030	1,901,557
2	Gjithsej te hyrat vetanake te komunës	159,038	159,330	165,151	171,584
2.1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	11,481	13,111	13,676	14,185
2.2	Te hyrat nga urbanizmi	19,100	8,200	9,800	11,600
2.3	Te hyrat nga administrata	7,100	7,200	7,300	7,400
2.4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	10,000	10,300	10,600	10,900
2.5	Te hyrat nga tatimi ne pronë	92,557	71,537	72,968	74,792
2.6	Të hyrat nga tatimi ne tokë		30,482	32,007	33,607
2.7	Regjistrimi i Automjeteve	6,000	6,300	6,400	6,500
2.8	Te hyrat nga shëndetësia	6,200	6,900	7,000	7,100
2.9	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	4,100	4,200	4,300	4,400
2.10	Të hyrat tjera	2,500	1,100	1,100	1,100
	TOTALI	1,658,591	1,877,346	1,989,181	2,073.141

Tabela 2. Vlerësimet e hershme të buxhetit 2023

Emri i Drejtorisë/Programit '000 euro	Viti buxhetor (2022)					Vlerësimi i hershëm Viti 1 (2023)					Vlerësimi i hershëm Viti 2 (2024)					Vlerësimi i hershëm Viti 3 (2025)				
	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali
Zyra e Kryetarit	78.7	6.7	0.2	50		76.0	7.7	0.2	52		76.4	7.7	0.2	52		76.7	7.7	0.2	52	
K. Komunal	60.2	4.0				59.4	4.0				59.4	4.0				59.5	4.0			
D. per planifikim urban, Gjeodezi dhe kadastrer	48.7	9.9			70	49.5	17.8			115	49.7	17.8			164	49.9	17.8			200
D. per Administratë të përgjithshme	85.7	49.3	6.7			85.7	47.1	7.2		30	86.1	47.1	7.2			86.4	47.1	7.2		
D. Buxhet dhe Financave	64.6	7.0	0.1			64.1	7.9	0.1			64.4	7.9	0.1			64.7	7.9	0.1		
D. Ekon. Bujqesi , pylltari dhe turizem	53.3	10.1	0.4		65	52.9	10.0	0.4		110	53.1	10.0	0.4		150	53.4	10.0	0.4		169
D. Sherbimeve Publike	55.9	36.5	13.3		70	53.9	33.8	13.6		110	54.1	38.8	14.7		150	54.4	41.8	15.0		170
D. e Arsimit	35.6	4.7				35.5	4.5				35.6	4.5				35.8	4.5			
D. e Shëndetsise	15.5	4.2				17.5	2.9				17.6	2.9				17.7	2.9			
ZKK	6.7					6.9					6.9					7.0				
TOTALI:	504.8	132.3	20.6	50	205	501.5	135.7	21.4	52	365	503.42	141	22.5	52	464	505.37	144	22.8	52	539
Arsimi fillor	289.4	32.2	4.9		10	299.7	30.5	5.0		20	300.9	32.5	5.0		20	302.1	33.5	5.0		20
Arsimi I mesem	125.5	10.7	3.6			124.2	16.1	3.6			124.7	16.1	3.6			125.1	16.1	3.6		
QKMF	224.4	24.1	5.7			234.2	37.6	5.7		10	235.2	37.6	5.7		10	236.1	37.6	5.7		10
Mirqenia Sociale	10.5	3.5	1.4			11.4	1.8	2.0			11.5	1.8	2.0			11.5	1.8	2.0		
SUB TOTALI	1154.6	202.8	36.2	50	215	1171	221.7	37.7	52	395	1175.6	229	38.8	52	494	1180.3	233	39.1	52	569

SPECIFIKACION

BUXHETI KOMUNAL JUNIK	VITI 2022 (000 EURO)	VITI 2023 (000 EURO)	VITI 2024 (000 EURO)	VITI 2025 (000 EURO)
	1,659	1,877	1,989	2,073

IV. Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pas për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2022.

Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend rritës për vitin 2023 gjithashtu edhe për dy vitet tjera pasuese me një trend të rritjes për çdo vjet.

Grandet qeveritare kanë rritje për vitin 2023 gjithashtu me një trend të rritjes në vitet pasuese të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i grandeve të MFPT.

Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal

Më datën 13.05.2022 kanë arritur limitet e para buxhetore për komunat për periudhën 2023/2025. Granti fillestar i Qeverisë për Komunën e Junikut është si vijon:

Tabela nr. 3 Limitet fillestare sipas qarkores buxhetore 2023/01

Limiti fillestar	Granti i Arsimit	Granti i Shëndetësisë	Granti i Përgjithshëm	Gjithsej granti Komunal
2023-Kufijtë e financimit	462,526	253,367	1,002,123	1,718,016
2024-Parashikimet	492,475	266,035	1,065,520	1,824,030
2025-Parashikimet	494,684	279,337	1,127,536	1,901,557

Tabela nr.4. Projekcioni i të hyrave Buxhetore nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake 2023/2025 të Komunës së Junikut

K. K. Junik	Buxheti - 2023	Buxheti – 2024	Buxheti – 2025
Të hyrat nga granti qeveritar	1,718,016	1,824,030	1,901,557
Të hyrat vetanake	159,330	165,151	171,584
TOTALI	1,877,346	1,989,181	2,073.141

Tabela nr. 5. Korniza afatmesme buxhetore 2023/2025 sipas kufijve fillestar

K. K. Junik	Buxheti - 2023	Buxheti - 2024	Buxheti – 2025
Paga dhe mëditje	1,170,906	1,175,602	1,180,271
Mallra dhe shërbime	221,740	228,740	232,740
Shpenzime komunale	37,700	38,839	39,130
Subvencione	52,000	52,000	52,000
Investime kapitale	395,000	494,000	569,000
TOTALI	1,877,346	1,989,181	2,073.141
Burimet e financimit			
Granti i Qeverisë	1,718,016	1,824,030	1,901,557
Të hyrat vetanake	159,330	165,151	171,584
TOTALI	1,877,346	1,989,181	2,073.141

Në tabelën vijuese pas pranimit të limiteve finale do të paraqesim shpërndarjen e buxhetit final sipas programeve për vitet 2023/2025

Strategjia e shpenzimeve sipas Drejtorive/Programeve dhe deklarata e misionit dhe qëllimeve

ZYRA E KRYETARIT

Kryetari: Ruzhdi Shehu

Deklarata e misionit: Kryetari i komunës, përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj, udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij; ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës; emëron dhe shkarkon zëvendësit dhe drejtorët e drejtorive; propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative e investuese, propozon Buxhetin komunal vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko - financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës; si dhe ndërmerr aktivitetet e tjera që i caktohen me statut, rregullore komunale apo akte të tjera ligjore dhe nën ligjore të cilat janë në fuqi.

Përgatitë të gjitha materialet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve etj. Gjithnjë me qëllim të arritjes të një qeverisje sa më të mirë, koordinon punën me të gjitha drejtoritë etj. Ofron çasje në dokumente zyrtare në mënyrë të arritjes së një transparence sa më të madhe në punë, etj.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi primar është që të gjitha kompetencat e Komunës të rregulluara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës të zbatohen në përpikëri në mënyrë që misioni i Komunës të shënoj shkallën sa më të lartë të performancës duke i realizuar me sukses qëllimet strategjike komunale.

Kategoritë buxhetore	2023	2024	2025
1 Paga dhe mëditje	76,003.45	76,353.84	76,704.20
2 Mallra dhe shërbime	7,700.00	7,700.00	7,700.00
3 Komunalit	150.00	150.00	150.00
5 Subvencione	52,000.00	52,000.00	52,000.00
6 Kapitalet	-	-	-
TOTALI	135,853.45	136,203.84	136,554.20
Numri i te Punësuarve	8	8	8

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL**Kryesuesi: Shpejtim Gacaferi**

Deklarata e misionit: Kuvendi i Komunës është organi më i lartë legjislativ i Komunës, i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

Kuvendi i Komunës mund të miratoj aktet dhe të ndërmerr masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre e që vlejnë brenda territorit të Komunës dhe në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, dhe atë: statutin e Komunës; rregulloren e punës; rregulloret komunale; dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin e komunës.

Deklarata e qëllimit: Zhvillimi lokal ekonomik, planifikimi urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, afirmimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ofrimin e për kujdesit publik shëndetësor, ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale; turizmin, aktivitetet kulturore dhe të lira, çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre apo që nuk është përcaktuar ndonjë autoritet tjetër.

Kategoritë buxhetore		2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	59,375.67	59,416.21	59,456.75
2	Mallra dhe shërbime	4,000.00	4,000.00	4,000.00
3	Komunalit	-	-	-
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	-	-	-
TOTALI		63,375.67	63,416.21	63,456.75
Numri i te Punësuarve		15	15	15

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**Drejtori: Leonora Shehu**

Deklarata e Vizionit: Ofrimi i shërbimeve efikase dhe të cilësisë së lartë, që u përgjigjen qytetarëve dhe i përmbushin nevojat e tyre.

Deklarata e Misionit: Udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet administrative – teknike të drejtorisë dhe ato të Shërbimit Civil Komunal që bien në këtë kompetencë. Udhëheqë me librat amë, të gjendjes civile, lëshon certifikata të gjendjes civile, sjellë aktvendime për regjistrime të mëvonshme, përmirësime dhe ndryshime të emrit e mbiemrit personal, harton aktet normative që bien në kompetencë të drejtorisë, udhëheq punën e arkivit komunal, zyrën e pritjes, sektorin teknik dhe të mirëmbajtjes, logjistikës, angazhohet dhe përcjellë punën e bashkëpunimit me vendbanimet dhe fshatrat. Gjithashtu kryen edhe punë të tjera që janë kompetencë e drejtorisë e që janë të bazuara në ligje, statut të Komunës, rregullore dhe udhëzime administrative, të cilat janë në fuqi.

Deklarata e Qëllimit: Koordinimi i punës me Drejtoritë Komunale në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Junikut. Pranimi i lëndëve nga palët dhe procedimi i tyre në zyrat e administratës Komunale, dhënia e informatave për palët lidhur me kërkesat dhe ankesat e tyre. Pajisja e palëve me kohë dhe në mënyrë transparente me dokumentacion personal nga librat e amzës. Përgatitja dhe plasimi me kohë në ueb-faqe të informatave për ecuritë, të arriturat dhe punën në Administratën Komunale si dhe shërbime të tjera që janë në kompetencë të drejtorisë në fjalë.

Kategoritë buxhetore		2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	85,707.59	86,063.22	86,418.80
2	Mallra dhe shërbime	47,100.00	47,100.00	47,100.00
3	Komunalit	7,200.00	7,200.00	7,200.00
5	Subvencione			
6	Kapitalet	30,000.00	-	-
TOTALI		170,007.59	140,363.22	140,718.80
Numri i te Punësuarve		14	14	14

Të hyrat vetanake		2023	2024	2025
1.	Te hyrat nga Administrata (Gjendja Civile LAL, LAM etj)	7,200	7,300	7,400
2.				
3.				
TOTALI:		7,200	7,300	7,400

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA**Drejtori: Vjollca Qesta**

Deklarata e Vizionit: Drejtoria për Buxhet dhe Financa do të jetë çdo herë e saktë në planifikime, e besueshme dhe transparente.

Deklarata e Misionit: Menaxhon dhe operon me mjetet buxhetore të Komunës, i siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon lidhur me aktualitetet e ndërlidhura me Buxhetin e Komunës. Përgatit raportet për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvend lidhur me menaxhimin e financave komunale, përgatitjen dhe prezantimin e Buxhetit, koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin. Gjithashtu, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa hyn edhe Zyra e Tatimit në pronë, e cila ka si mision inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë, që dedikohen për projekte kapitale, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Deklarata e Qëllimeve:

- Planifikimi i saktë dhe efikas i Buxhetit
- Shpenzimi i Buxhetit në mënyrë racionale dhe në përputhje me ligjet në fuqi
- Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake komunale

Kategoritë buxhetore		2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	64,142.44	64,423.49	64,704.58
2	Mallra dhe shërbime	7,900.00	7,900.00	7,900.00
3	Komunalit	100.00	100.00	100.00
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	-	-	-
TOTALI		72,142.44	72,423.49	72,704.58
Numri i te Punësuarve		9	9	9

Të hyrat vetanake		2023	2024	2025
1.	Te hyrat nga Tatimi ne pronë	71,537	72,968	74,792
2.	Te hyrat nga Tatimi ne tokë	30,482	32,007	33,607
3.	Te hyrat nga regjistrimi i automjeteve	6,300	6,400	6,500
4.	Te hyrat tjera	1,100	1,100	1,100
TOTALI:		109,419	112,475	115,999

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE INSPEKSIONI**Drejtori: Demokrat Ganiqaj**

Deklarata e misionit: Misioni i përgjithshëm i DSHP-së është realizimi i suksesshëm i Planit për Parandalimin e Emergjencave, reagimin e shpejtë dhe të suksesshëm ndaj emergjencave, intervenime të suksesshme të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, rritjen e performansës në Shërbimin e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, mirëmbajtja e pastërtisë së qytetit, rritjen e performansës në transportin publik të udhëtarëve, ndriçimin elektrik të qytetit si dhe rritjen e performansës në ndërmarrjet publike për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi i drejtorisë do të jetë ndërtimi dhe riparimi i rrugëve të qytetit dhe atyre lokale, ndërtimi i rrjeteve të reja të ujësjellësit, ndërtimi i rrjeteve të reja të kanalizimit të ujërave të zeza, ndërtimi i parqeve, shesheve dhe sipërfaqeve të gjelbëruara, ndërtimi i rrjeteve të reja të ndriçimit publik.

Kategoritë buxhetore		2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	53,927.50	54,140.76	54,354.05
2	Mallra dhe shërbime	33,800.00	38,800.00	41,800.00
3	Komunalit	13,550.00	14,689.00	14,980.00
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	110,000.00	150,000.00	170,000.00
TOTALI		211,277.50	257,629.76	281,134.05
Numri i te Punësuarve		8	8	8

Të hyrat vetanake		2023	2024	2025
1.	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	4,200	4,300	4,400
2.				
3.				
TOTALI:		4,200	4,300	4,400

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK**Drejtori: Gentiana Tofaj****Deklarata e Vizionit:**

Zhvillimi, promovimi i turizmit dhe monumenteve kulturore do jetë qëllimi kryesor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, duke marrë parasysh resurset natyrore dhe historinë e qytetit.

Deklarata e Misionit:

Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, zhvillim të bujqësisë, pylltarisë dhe bletarisë, me qëllim tërheqjen e investitoreve për të krijuar një mjedis të favorshëm për qytetarët e Komunës së Junikut.

Deklarata e Qëllimeve:

Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, zhvillim të bujqësisë, pylltarisë dhe bletarisë, me qëllim tërheqjen e investitoreve për të krijuar një mjedis të favorshëm për qytetarët e Komunës së Junikut.

Projektet e hartuara do gjejnë zbatim në disa mënyra: Përmes investimeve kapitale (pënda dhe kanale të ujitjes), Ofrimit të Shërbimeve Këshillimore, (në ngritja e kapaciteteve të fermerëve në mienaxhimin e fermave dhe aplikimin e teknologjive të avancuara në prodhimtarin bujqësor), mbështetjes për sektorin e blegtorisë, bletarisë, perimekulturës, pemëtarisë, dhe hulumtimi i burimeve financiare (garantëve dhe subvencione) për sektorin e bujqësisë dhe bletarisë, mbështetje për iniciativat e reja të fermerëve në prodhimtarin bujqësor (në ngritjen e cilësisë dhe sasisë të prodhimeve bujqësore).

Ruajtja dhe ripyllëzimi i tokave pyjore, duke parandaluar dhe shëruar nga dëmtuesit dhe sëmundjet që i atakojnë.

Bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, bizneset lokale dhe të jashtëm, drejt realizimit të projekteve zhvillimore komunale.

Kategoritë buxhetore	2023	2024	2025
1 Paga dhe mëditje	52,896.69	53,130.16	53,363.58
2 Mallra dhe shërbime	10,000.00	10,000.00	10,000.00
3 Komunalit	400.00	400.00	400.00
5 Subvencione			
6 Kapitallet	110,000.00	150,000.00	169,000.00
TOTALI	173,296.69	213,530.16	232,763.58
Numri i te Punësuarve	10	10	10

Të hyrat vetanake	2023	2024	2025
1. Te hyrat nga ushtrimi i veprimtarive të bizneseve	10,300	10,600	10,900
2.			
3.			
TOTALI:	10,300	10,600	10,900

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MJEDISIT**Drejtori: Zenun Shala**

Deklarata e Vizionit: Komunë e planifikuar dhe ndërtuar sipas planeve hapësinore duke ruajtur mjedisin dhe lehtësuar jetën e qytetarëve, me kadastrë të digjitalizuar dhe shërbime në kohë reale.

Deklarata e Misionit: Zbatimi me përpikshmëri i planeve hapësinore , mjedisore dhe azhurnimi i kadastrit në vazhdimësi.

Deklarata e Qëllimeve: ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve duke respektuar normat teknike të ndërtimit, planifikimit, ato mjedisore dhe kadastrale.

Kategoritë buxhetore	2023	2024	2025
1 Paga dhe mëditje	49,502.03	49,720.35	49,938.67
2 Mallra dhe shërbime	17,800.00	17,800.00	17,800.00
3 Komunalit			
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet	115,000.00	164,000.00	200,000.00
TOTALI	182,302.03	231,520.35	267,738.67
Numri i te Punësuarve	7	7	7

Të hyrat vetanake		2023	2024	2025
1.	Te hyrat nga Urbanizmi (lejet e ndërtimit)	8,200	9,800	11,600
2.	Te hyrat nga shërbimet kadastrale	13,111	13,676	14,185
3.				
	TOTALI:	21,311	23,476	25,785

DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT**Drejtori: Xhavit Velijaj**

Deklarata e Vizionit: DAKRS do të jetë gjithmonë korrekte dhe transparente në të gjitha synimet e saj për ngritjen e cilësisë së arsimit në komunën e Junikut.

Deklarata e Misionit: DAKRS, udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet arsimore – administrative- teknike të Drejtorisë dhe shkollave dhe është përgjegjëse për zbatimin e ligjshmërisë dhe aktet nënligjore në fushën e arsimit në nivel komunal.

Deklarata e Qëllimeve: DAKRS, planifikon, udhëheq dhe koordinon të gjitha aktivitetet në pjesëmarrje në procesin e regrutimit të personelit arsimor, teknik dhe Drejtorit në shkollë, mbledhë dhe analizon informatat për të gjitha çështjet e arsimit, siguron infrastrukturën dhe hapësirën e nevojshme shkollore për përfshirjen e të gjithë fëmijëve dhe të rriturve në shkollim, planifikon trajnimet e nevojshme për personelin e shkollave dhe Drejtorisë, bën planifikimin dhe shfrytëzimin racional të buxhetit, krijon kushte për komunikim me prind dhe publikun për çështje që kanë të bëjnë me procesin arsimor dhe kryen punë tjera që obligohet nga komuna dhe MASHT-i.

Administrata, Drejtoria e Arsimit

Kategoritë buxhetore		2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	35,454.01	35,611.25	35,768.57
2	Mallra dhe shërbime	4,500.00	4,500.00	4,500.00
3	Komunalit			
5	Subvencione			
6	Kapitalet			
TOTALI		39,954.01	40,111.25	40,268.57
Numri i te Punësuarve		5	5	5

Shkolla fillore “ EDMOND HOXHA”

Kategoritë buxhetore	2023	2024	2025
1 Paga dhe mëditje	299,666.43	300,880.06	302,093.11
2 Mallra dhe shërbime	30,540.00	32,540.00	33,540.00
3 Komunalit	5,000.00	5,000.00	5,000.00
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet	20,000.00	20,000.00	20,000.00
TOTALI	355,206.43	358,420.06	360,633.11
Numri I te Punësuarve	48	48	48

Shkolla e mesme “ KUVENDI I JUNIKUT”

Kategoritë buxhetore	2023	2024	2025
1 Paga dhe mëditje	124,177.91	124,670.68	125,137.07
2 Mallra dhe shërbime	16,100.00	16,100.00	16,100.00
3 Komunalit	3,600.00	3,600.00	3,600.00
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet			
TOTALI	143,877.91	144,370.68	144,837.07
Numri I te Punësuarve	18	18	18

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**Drejtori: Fatos Shala****Deklarata e Misionit:**

Misioni i DSHMS-së është zhvillimi dhe sigurimi i shërbimeve efektive për plotësimin e nevojave të popullsisë së Komunës. Sigurimi i kornizës menaxhuese për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore të qëndrueshme në nivelin primar shëndetësor, përmirësimi i vazhdueshëm kualitativ të shërbimeve shëndetësore.

Deklarata e Qëllimeve:

Përmirësimi i duhur i shëndetit të qytetarëve, parandalimi i sëmundjeve ngjitëse, imunizimi dhe vaksinimi, ofrimi i shërbimeve sa më cilësore dhe efikase në kujdesin primar shëndetësor.

Administrata, Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale

Kategoritë buxhetore		2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	17,539.70	17,616.96	17,694.27
2	Mallra dhe shërbime	2,900.00	2,900.00	2,900.00
3	Komunalit			
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	-	-	-
	TOTALI	20,439.70	20,516.96	20,594.27
	Numri i te Punësuarve	2	2	2

QKMF

Kategoritë buxhetore	2023	2024	2025
1 Paga dhe mëditje	234,177.05	235,159.41	236,141.75
2 Mallra dhe shërbime	37,600.00	37,600.00	37,600.00
3 Komunalit	5,700.00	5,700.00	5,700.00
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet	10,000.00	10,000.00	10,000.00
TOTALI	287,477.05	288,459.41	289,441.75
Numri i te Punësuarve	33	33	33

Të hyrat vetanake	2023	2024	2025
1. Te hyrat nga Shëndetësia	6,900	7,000	7,100
2.			
3.			
TOTALI:	6,900	7,000	7,100

Shërbimet sociale

Kategoritë buxhetore	2023	2024	2025
1 Paga dhe mëditje	11,426.06	11,475.65	11,525.19
2 Mallra dhe shërbime	1,800.00	1,800.00	1,800.00
3 Komunalit	2,000.00	2,000.00	2,000.00
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet	-	-	-
TOTALI	15,226.06	15,275.65	15,325.19
Numri i te Punësuarve	2	2	2

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE**Udhëheqës:**

Deklarata e misionit:

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryetarit, ndihmon në përpilimin e strategjisë së kthimit në nivel komunal. Harton informata lidhur me kthimet dhe ri integrimet në Komunë.

Kategoritë buxhetore		2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	6,909.46	6,939.96	6,970.41
2	Mallra dhe shërbime			
3	Komunalit			
5	Subvencione			
6	Kapitalet			
	TOTALI	6,909.46	6,939.96	6,970.41
	Numri i te Punësuarve	1	1	1

Programi komunal i investimeve publike (PIP) -

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim Listën e projekteve kapitale të parapara me Buxhetin e vitit 2022, me financim nga të hyrat e fondit të ndarë për Komunën e Junikut, si dhe Listën e projekteve për vitet 2023/2025 të parapara me financim nga të hyrat vetanake dhe nga donatorët. Kjo listë mund të modifikohet me propozime të reja që do të vinë nga Drejtoritë gjatë shqyrtimit me Drejtorët e Drejtorive, palët e interesit, strukturat tjera udhëheqëse dhe organeve relevante komunale për hartimin e politikave zhvillimore të Komunës duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për financim si dhe aftësi dhe burimeve të ardhurave komunale, si dhe Grandet e Qeverisë, Partecipimet e qytetarëve dhe Donatorët e ndryshëm.

Nr.	Përshkrimi i projektit	Drejtoria	Burimi i financimit	Shuma totale e financimit	Financimi sipas viteve ('000 euro)			
					2022	2023	2024	2025
					Buxheti			
1	Bashkëfinancim i projekteve	DZHE	KK. Junik	240	50	60	65	65
2	Rehabilitimi i rrugëve lokale	DSHPMI	KK. Junik	85	15	30	20	20
3	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes	DZHE	KK. Junik	110	20	30	30	30
4	Asfaltimi i rrugëve lokale në lagjet e Junikut	DUKM	KK. Junik	100	20	40	40	
5	Hapja e rrugëve fushore	DZHE	KK. Junik	80	5	25	25	25
6	Rregullimi i hapësirave sportive, rekreative, dhe të ambientit në shkollën fillore "Edmond Hoxha"	DAKRS	KK. Junik	30	10	10	10	
7	Ndërtimi i sheshit të Qendrës të Komunës së Junikut	DUKM	KK. Junik	240	50	100	90	
8	Asfaltimi i rrugës lokale Junik - Jasiq	DSHPMI	KK. Junik	145	145			
9	Ndërtimi i rrëthojës dhe rregullimi i oborrit në QPS	DSHMS		10		10		
10	Ndërtimi i rrjetit sekondar të kanalizimit për ujëra të zeza	DUKM		150	20	100	30	
11	Furnizimi me shporta dhe kontejner për mbeturina	DSHPMI		10		5	5	
12	Blerja e automjetit për nevoja të komunës	DAP		30		30		
13	Furnizim me gjenerator për objektin e Administratës	DAP		15		15		
14	Hartimi i hartave zonale	DUKM		20	5	10	5	
15	Ndërtim i parqeve dhe këndeve të lojërave për Fëmijë	DUKM		70	10	30	30	
16	Ndërtimi i Objektit social për banim	DSHMS		218.5		105	113.5	
17	Ndërtimi i rrjetit elektrik Gjocaj -Gjeravicë	DSHPMI		250		50	100	100
18	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Lagjen Agim Ramadani	DSHPMI		100	50	50		
19	Hapja, Gjurmimi dhe Vënia në funksion e vendbanimit të periudhës së bronzit për vizitorët "Gropa e Amonit"	DZHE		390				390
20	Restaurimi dhe vënia në funksion e monumenteve të vjetra si: Kullat, Mullinjtë dhe Valavicat	DZHE		300		100	100	100

21	Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve të reja për ecje qarku Moronicë- Zharre	DZHE		30			30	
22	Rekonstruimi i rrugës "Junik - Rastovic"	DUKM		500		250	250	
23	Asfaltimi, kanalizimi dhe ujësjellësi në fshatin Gjocaj, Jasiq	DUKM		200		100	100	
24	Ndërtimi i linjës Via-Ferrata në Lokacionin "Shkëmbi i Jedovës"	DZHE		10		10		
25	Ndërtimi i objektit të Shkollës Filllore	DAKRS	MAKRS	650	650			
26	Ndërtimi i fushës sportive në SHFMU "Edmond Hoxha"	DAKRS		50		50		
27	Rregullimi i planeve të hollësishme të komunës	DUKM		50		25	25	
28	Ndërtimi i ujëmbledhësve në Komunën e Junikut	DUKM		2,500		1,000	1,000	500
29	Hartimi i projektit për ndërtimin e ujëmbledhësit dhe rrjetit të ujitjes në Junik	DUKM		35		35		
30	Ndërtimi i Ashensorit në QKMF	DSHMS		30		30		
31	Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Erenik Segmenti Berishë -Nivokaz	DUKM		40		20	20	
32	Ndërtimi i rrjetit elektrik eficient lokal	DSHPMI		30		10	20	
33	Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Erenik Segmenti Tofaj –Qafa e Jasiqit	DUKM		40		20	20	
34	Zërimi i asamblesë komunale	DAP		26		26		
35	Hapja e shtegut malorë për Biciklistë	DZHE		15		5	5	5
36	Hapja dhe trasimi i rrugëve malore	DZHE		210			200	10
37	Ndërtimi i tranzitit Botushë-Nivokaz-Dobrosh-Pacaj- Hereq	DUKM		300		100	100	100
38	Ndërtimi i palestrës sportive në Junik	DAKRS		700	350	350		
39	Pyllëzimi i hapësirave të zhveshura	DZHE		120		40	40	40
40	Ndërtimi i shtratit të lumit Erenik segmenti Tofaj – Qafa e Jasiqit	DUKM		500			250	250
41	Ruajtja, Sanimi dhe Rregullimi i burimeve të ujit të pijes në Ekofshatrat-Bjeshkë	DZHE		30		30		
42	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave rekreative dhe sportive përgjatë lumit Erenik	DSHPMI		200		30	70	100
43	Ndërtimi i zonës ekonomike për investitorë të huaj	DZHE		300			150	150
44	Ndërtim i trotuarit në rrugën Gaxherr-Bajraktar - Pepsh	DUKM		100		50	50	
45	Rregullimi i Sheshit në Qendër të qytetit	DUKM		800		200	300	300
46	Ndërtimi i palestrës sportive në Gjimnazin "Kuvendi i Junikut"	DAKRS		500		100	200	200
47	Ndërtimi i qerdhës për fëmijë	DAKRS		200	100	50	50	
48	Rregullimi i oborrit në Shkollën filllore "Edmond Hoxha"	DAKRS		100		50	50	
49	Infrastruktura rrugore për persona me mobilitet të zvogëluar	DSHPMI		10		10		
50	Ndërtimi i kompleksit të dëshmorëve	DUKM		100			50	50
51	Ndërtimi i pendës së ujitjes në Qafë të Jasiqit- Tofaj- Pepsh	DZHE		50		50		
52	Ndërtimi i pishinave verore	DZHE		200			100	100

53	Kanalet e ujitjes në Bramatoqje	DUKM		200			100	100
54	Rregullimi i shtratit të lumit Erenik segmenti Berishë- Nivokaz	DUKM		1,000			500	500
55	Rekonstruimi i urës së Gurit	DUKM		30		30		
56	Zgjerimi i rrugës "Qendër-Shkollë Fillore- Pepsh- Teqja Halvetije Xhaferije"	DUKM		400			200	200
57	Ndërtimi i pallatit të kulturës	DAKRS		1,500				1,500
58	Asfaltimi i rrugës së Turbisë	DUKM		200			100	100
59	Ndërtimi i qendrës Kulturore-Historike- Tradicionale-Junikase	DAKRS		130		70	60	
60	Kohëzimi i rrugëve	DSHPMI		15			15	
61	Rregullimi i shëtitores përgjatë lumit Trava	DUKM		200		100	100	
62	Rregullimi i kanaleve të ujitjes në lagjen Hoxhë deri në Fidanishtë	DZHE		60		30	30	
63	Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i varrezave	DSHPMI		100			50	50
64	Gjelbërimi i hyrjeve të qytetit të Junikut me drunjë dekorativ	DSHPMI		15		5	5	5
65	Rregullimi i hapësirave tek parku Moronica	DUKM		55			55	
66	Shndërrimi i hapësirave përgjatë lumit Erenik në zona rekrative	DSHPMI		25		10	15	
67	Hapja dhe shënjëzimi i shtigjeve të ecjes për tek Kanioni i Erenikut	DZHE		20		5	5	10
68	Funksionalizimi i parqeve, vendosja e ulëseve, shportave për mbeturina	DSHPMI		10		5	5	
69	Vendosja e kabinave pritëse në stacione nëpër lagje	DSHPMI		10		5	5	
70	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi i rrugës Qendër-Lagjja Agim Ramadani	DUKM		300		100	100	100
72	Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve në parkun Moronica	DZHE		30			10	20
73	Hartimi i projektit për ndërtimin e sheshit prej Qendrës deri te Shkolla Fillore	DUKM		100		50	50	
74	Ndërtimi i Depos së Komunës	DAP		5		5		
75	Renovimi i objektit të komunës	DAP		50			50	
76	Ndërtimi i parkingut nëntokësor	DAP		350			200	150
77	Ndërtimi i parkingut në lagjen Bajraktar	DAP		50			50	
78	Ndërtimi i shtegut në brendi të Kanionit të Junikut me material metalik dhe druri	DZHE		15		15		
79	Ndërtimi i pikave vrojtuese panoramike në Bjeshkët e Junikut	DZHE		10		5	5	
80	Hapja dhe Rregullimi i shtegut për lëshim me Bicikleta "Livadhi i Bahqit-Livadhi i Verrave"	DZHE		10		10		
81	Ndërtimi i shtegut për biçiklista	DSHPMI		10		10		
82	Rregullimi i kanaleve të ujitjes në lagjen Malok i poshtëm	DZHE		20		10	10	
83	Instalimi i pompave termike në objektin e Komunës së Junikut	DSHPMI		50		25	25	
84	Instalimi i pompave në objektet e Institucioneve tjera Publike në Komunën e Junikut	DSHPMI		200		50	50	100
85	Ndërtimi tregut të gjelbër	DZHE		25		15	10	
86	Ndërtimi i Liqenit artificial	DZHE		50			25	25
87	Ndërtimi i Qendrës së skijimit	DZHE		240			140	100

88	Ndërtimi i pikave grumbulluese të produkteve bujqësore	DZHE	30		15	15
89	Ndërtimi i Bujtinave Turistike	DZHE	150		100	50
90	Zhvillimi i projekteve për shtim të fondit të Blegtorisë së lmtë.	DZHE	100	30	40	30
91	Blerja e Autoambulancës dhe pajisjeve mjekësorë	DSHMS	35	10	25	
92	Hartimi i planeve rregulluese Urbane për Gryken e Erenikut me lokalitetet: Gradinë, Jedovë, Liqejt e Gjeravicës dhe Rrasa e Zogut.	DUKM	100	50	50	
93	Parku i Paqes në kufirin Shqipëri-Kosovë-Mali i zi (ndërtimi i kampingut)	DUKM	150	100	50	
94	Ndërtim i impianteve të ujerave të zeza dhe trajtimi i tyre.	DUKM	1.200	500	500	200
95	Ndërtimi i rrugës Gropa e Erenikut Bogiqe (Kufiri Kosovë-Shqipëri-Mali i zi)	DUKM	800	200	300	300
96	Studimi i Fizibilitetit për shtrirjen e nxemjës gendrore në Qytetin e Junikut.	DUKM	300	150	150	
97	Hapja e Rrugëve fushore Qafa e Jasiqit-Firza	DSHPMI	30	15	15	
98	Rregullimi dhe kycja në kanalizim për lagjen Miroc	DSHPMI	60	30	30	
99	Hartimi i projektit të fushës së Futbollit	DAKRS	10	10		
100	Ndërtimi i fushës së Futbollit	DAKRS	300		150	150
101	Rikonstruimi i objektit të shkollës së vjetër	DAKRS	50		30	20
102	Ndërtimi i rrjetit elektrik në lagjen Isufaj-Moronicë	DSHPMI	30	15	15	
103	Rregullimi i kanaleve të ujërave të zeza në lagjen Pepsh	DSHPMI	30	15	15	
104	Vazhdimi i kanaleve të ujitjes në lagjen Miroc	DZHE	50	25	25	
105	Ndërtimi i kanalit të ujitjes nga Shkolla Fillore deri në lagjen Kuka	DZHE	20	10	10	
106	Rehabilitimi i rrugëve dhe kanaleve në segmentin Bajraktar-Gaxherr	DSHPMI	100	50	50	
107	Hapja e rrugëve fushore në lokacionin Troja-Berishë	DSHPMI	20	10	10	
108	Ndërtimi i tretoarëve segmenti Qendër-Kallavaj	DSHPMI	100	50	50	
110	Studimi i fizibilitetit për Bjeshkët e Junikut	DUKM	60	30	30	
111	Studimi i fizibilitetit për shtratin e lumit Erenik	DUKM	50	25	25	

P. S. Vlerat e prezantuar në tabelë janë të shprehura në mijë (000) euro.



Drejtoresha për Buxhet dhe Financa
Vjollca Qestaj





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Nr: 02/14/22;
Datë: 30.06.2022 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe Qarkores Buxhetore 2020/01 për Komunat, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 29.06.2022 nxjerrë:

V E N D I M

për

miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2023 - 2025

I. Me këtë vendim miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) në kufijtë preliminar të buxhetit komunal të Komunës së Junikut për periudhën 2023 – 2025 e propozuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut, me një kërkesë për përkrahje me mjete buxhetore shtesë të cilat janë pjesë e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2023-2025.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2023 -2025.

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Kryetari i Komunës së Junikut;
- Shërbimi i kuvendit të komunës; dhe
- Arkivi i komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim Gacaferi



kryesues